

**STATUTI**  
**I**  
**SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**LEGAL OF DIGITAL Sh.p.k.**

**I. THEMELIMI**

**Neni 1**  
**Ortaket themelues**

- 1.1 Shoqeria **LEGAL OF DIGITAL Sh.p.k** themelohet nga ortaket:
1. **Z. Gentian Muskaj**, atësia Shqyri, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në Tirane, lindur më 14/07/1988, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Leternjoftim ID nr. 038128983 dhe nr. personal I80714085T, dhe
  2. **Z. Isan Hydi**, shtetas Shqiptar, lindur në Berat dhe banues në Tirane, lindur më 19/05/1980, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Pashaporten me nr. personal I00519063A

**II. EMERTIMI. SELIA. FORMA LIGJORE**

**Neni 2**  
**Emertimi**

- 2.1 Shoqeria emertohet **LEGAL OF DIGITAL sh.p.k.**

**Neni 3**  
**Forma ligjore**

- 3.1 Shoqeria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k), ne baze te ligjit "Per shoqerite tregtare".
- 3.2 Shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

**Neni 4**  
**Baza ligjore**

- 4.1 Shoqeria **LEGAL OF DIGITAL Sh.p.k.**, do te kryeje veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, me kete Statut, ligjin nr. 7638 date 19 Nentor 1992 "Per shoqerite tregtare" dhe dispozitat e tjera te legjislacionit shqiptar.



**Neni 5**  
**Kohezgjatja**

- 5.1 Veprimtaria e Shoqerise do te filloje pas regjistrimit ne QKR.
- 5.2 Veprimtaria e shoqerise do te zgjase per nje afat kohe te pacaktuar.

**Neni 6**  
**Selia**

- 6.1 Selia e shoqerise eshte ne **Rruga Artan Lenja, vile 3 kateshe Nr.7, Kati 1, Tirane 1001, Shqiperi**
- 6.2 Shoqeria ka te drejte te krijojë dege, filiale ose / dhe zyra perfaqesimi ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe jashtë vendit.
- 6.4 Shoqeria parashikon edhe mundësinë e pjesëmarrjes në shoqëri të tjera ekzistuese ose në shoqëri që në të ardhmen do të zhvillojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë tij me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

**Neni 7**  
**Vula**

- 7.1 Shoqeria do te kete vulen e saj qe do te perdoret bashkerisht ose vecas nga administratori/et.
- 7.2 Forma e vules dhe permasat e saj do te percaktohen nga Asambleja e Ortakeve ne perputhje me kerkesat perkatese ligjore ne Shqiperi.

**Neni 8**  
**Objekti**

- 8.1 Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

1. Ofrimi i shërbimeve të konsulencës ligjore të specializuar në sektorin dixhital, përfshirë legjislacionin mbi mbrojtjen e të dhënave personale, privatësinë, të drejtat e autorit, tregtinë elektronike dhe sigurinë informatike.
2. Ofrimi i konsulencës strategjike dhe operative për departamentet dixhitale të ndërmarrjeve, duke mbështetur transformimin dixhital dhe optimizimin e proceseve të biznesit përmes zgjidhjeve teknologjike ekzistuese.
3. Prestimi i shërbimeve të konsulencës fiskale dhe tregtare, duke përfshirë menaxhimin kontabel, planifikimin fiskal, revizionin dhe konsulencën për operacione me karakter të jashtëzakonshëm.
4. Themelimi dhe menaxhimi i një sektori të agjencisë së punës, i dedikuar për ndërmjetësimin, përzgjedhjen dhe vendosjen e personelit, me një referencë të veçantë për profesionistët në sektorin dixhital dhe teknologjik.
5. Drejtimi i aktiviteteve të formimit profesional dhe përditësimit të vazhdueshëm në fushën e së drejtës dixhitale, praktikave fiskale dhe tregtare, dhe metodologjive të punës së përkohshme.
6. Kryerja e çdo aktiviteti tjetër të lidhur, të ngjashëm ose instrumental me ato të përmendura më

lart, si dhe pjesëmarrja në shoqëri të tjera, ente ose ndërmarrje, edhe me natyrë të ndryshme, gjithmonë me qëllimin e mbështetjes së ekosistemit ndërmarrësor në rrugëtimin e tij drejt dixhitalizimit dhe inovacionit. Shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet pasurore, financiare (përveç atyre të rezervuara për institucionet e nënshtuar legjislacionit të veçantë), tregtare dhe të investimit të cilat konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektit shoqëror, duke respektuar ligjshmërinë në fuqi

8.2 Objekti i shoqërisë mund të zgjerohet ose ndryshojë me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

### **Neni 9 Kapitali**

9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 1000 (njemije) lekë, i nënshkruar dhe i shlyer plotësisht nga themeluesi dhe zotërohet nga ortakët e mëposhtëm:

1. Z. Gentian Muskaj, atësia Shyqyri, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, lindur më 14/07/1988, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Leternjoftim ID nr. 038128983 dhe nr. personal I80714085T, në kuotën **50% te kapitalit**, me të drejte vote.
2. Z. Isan Hydi, shtetas Shqiptar, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, lindur më 19/05/1980, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Pashaportën me nr. personal I00519063A, në kuotën **50% te kapitalit**, me të drejte vote.

### **Neni 10 Transferimi i pjeseve të kapitalit themeltar**

10.1 Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen vetëm me akt noterial.

## **ORGANET E SHOQERISE**

### **Neni 11 Asambleja e Ortakëve**

11.1 Asambleja e Ortakëve është organi me i lartë vendimor i shoqërisë.

11.2 Asambleja e Ortakëve drejton veprimtarinë e shoqërisë nëpërmjet marrjes së vendimeve. Vendimet e Asamblese përfshijnë kryesisht:

- ndryshimin e selisë;
- ndryshimin e emertimit të shoqërisë;
- rritjen ose zvogelimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- shitjen ose transferimin e pjeseve të kapitalit themeltar paleve të treta;
- prishjen e shoqërisë;

- likuidimin e shoqerise;
- emerimin ose shkarkimin e administratorit / administratoreve te shoqerise
- miratimin e bilancit te shoqerise;
- transformimin e shoqerise ne forma te tjera.

**Neni 12**  
**Asambleja e Zakonshme**

- 12.1 Mbledhja e Asamblese se Ortakeve mund te thirret ne cdo kohe nga Administratori ose ortaket.
- 12.2 Nje ortak mund te perfaqesohet nga nje perfaqesues me prokure. Nje ortak mund te perfaqesoje vetem njerin prej ortakeve te tjere.

**Neni 13**  
**Asambleja e Jashtezakonshme**

- 13.1 Ne mbledhjet e jashtezakonshme vendimet merren nga ortaku.

**Neni 14**  
**Thirrja dhe zhvillimi i mbledhjeve**

- 14.1 Mbledhjet zhvillohen ne seline e shoqerise ose ne cdo vend tjeter te njoftuar nga njeri prej administratoreve.
- 14.2 Njoftimi kryhet me shkrim, me leter rekomande', dhe poste tjeter te regjistruar, te pakten 15 dite perpara dates se zhvillimit te mbledhjes dhe permban daten, vendin, oren dhe rendin e dites se mbledhjes.

**Neni 15**  
**Marrja e vendimeve**

- 15.1 Vendimet merren me vota te ortakeve te pranishem personalisht ose te perfaqesuar.
- 15.2 Cdo vote perfaqeson pjeset e kapitalit.
- 15.3 Votat numerohen nga drejtuesi i mbledhjes i caktuar ne celjen e saj dhe regjistrohen ne Librin e Ortakeve.
- 15.4 Libri mbahet nga njeri prej administratoreve ose nje sekretar i mbledhjes qe nenshkruan se bashku me drejtuesin e mbledhjes.

**Neni 16**



## Administrimi

- 16.1 Administrimi i shoqerise kryhet nga nje administrator ose nga nje grup administratoresh qe caktohen nga Asambleja e ortakeve.
- 16.2 Administratoret nuk jane detyrimisht ortake, por mund te jene edhe jo ortake.
- 16.3 Administratoret kane te drejte te perfaqesojne shoqerine dhe drejtojne punen e perditshme te shoqerise ne perputhje me udhezimet e Asamblese se Ortakeve.
- 16.4 Administratoret jane solidarisht pergjigjes per veprimtarite e meposhtme:
- drejtimin e veprimtarise se perditshme te shoqerise;
  - perfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me te tretet personalisht ose duke caktuar zevendesues;
  - pergatitjen e mbledhjeve te Asambleve te Ortakeve dhe plotesimin e procedurave te thirrjes se tyre;
  - hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit vete; emerimin e eksperteve kontabel, ne rast nevojje;
  - pergatitjen e dokumenteve ne emer te shoqerise sipas kompetencave qe kane;
  - lidhin kontrata pune dhe i zgjidhin ato sipas rastit;
  - zhvillojne veprimtari te tjera te cdo lloj natyre per te miren e shoqerise dhe realizimin e objektit te shoqerise.
- 16.5 Shoqeria do te administrohet nga nje administrator, **Znj. Teuta Muskaj** me numer personal **G25708056B**, mandati i te ciles do te jete per nje afat **5 vjecar** nga data **06.11.2023 deri me 06.11.2028**.

## Neni 17 Viti financiar

- 17.1 Viti financiar i shoqerise perputhet me vitin kalendarik, duke filluar ne 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor.
- 17.2 Si perjashtim, viti i pare i veprimtarise se shoqerise dhe do te filloje nga dita e regjistrimit te shoqerise prane organeve tatimore dhe perfundon me 31 Dhjetor 2023.

## Neni 18 Bilanci. Mbajtja e kontabilitetit

- 18.1 Bilanci vjetor i Shoqerise shqyrtohet ne mbledhjet e Asamblese se ortakeve dhe duhet te hartohet per tju paraqitur organeve tatimore ne datat e parashikuara ne Ligj.
- 18.2 Kontabiliteti mbahet ne gjuhen dhe ne monedhen Shqiptare. Shoqeria mund te kete edhe llogari te vecanta ne valute.



- 18.3 Shoqeria mund te marre financime nga ortaket, institucione financiare qe operojne ne Shqiperi ose jashte saj. Per kete qellim shoqeria mund te jape si garanci barre mbi pjeset e kapitalit ose sende te paluajtshme, me autorizim te Asamblese se Ortakeve.

**Neni 19**  
**Likuidimi**

- 19.1 Shoqeria do te hyje ne procesin e likujdimit, nese:
- gjendja ekonomike ne Shqiperi nuk do te lejoje vazhdimin e veprimtarise se shoqerise;
  - Asambleja e Ortakeve vendos te prishe shoqerine.
- 19.2 Ne menyre qe te ndermarre procedurat e likujdim, Asambleja e Ortakeve emerone nje likuidator ose nje grup likuidatoresh,
- 19.3 Likuidatori/likuidatoret do te raportojne mbi gjendjen e zerave te aktivitetit dhe te pasivitetit te shoqerise rreth operacioneve te metejshme te likuidimit dhe kohen qe nevojitet per perfundimin e tij. Ne fund te ketij procesi, Asambleja e Ortakeve shqyrton bilancin perfundimtar dhe mbylljen e procedures se likuidimit.

**Neni 20**  
**Zgjidhja e mosmarreshjeve**

- 20.1 Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten, palet i drejtohen per zgjidhje Arbitrazhit Tregtar prane Qendres Shqiptare per Ndermjetesim dhe Arbitrazh Tregtar.

**Neni 21**  
**Klauzola mbyltese**

- 21.1 Ky statut hartohet ne 5 ekzemplare, ne gjuhen Shqipe secili me vlere te njejte ligjore.

Tirane me 06.11.2023

**ORTAKET THEMELUES**

Z. Gentian Muskaj



Gentian Muskaj

Z. Isan Hydi



Isan Hydi